



Prishtinë, 19/08/2022

## Përgjigje në komentet e ZRRE në Aplikacionin për Tarifa të NQ Termokos për sezonin 2022/2023

### Hyrije

Zyra e Rregulatorit për Energji (ZRRE) në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të veta ka filluar shqyrtimin e tarifave të energjisë termike për NQ Termokos për sezonin 2022/2023; në këtë aspekt me dt. 06 qershor 2022, NQ Termokos-it i është dërguar shkresa-njoftimi për fillimin e shqyrtimit tarifor për sezonin 2022/2023 dhe “Plani i zbatimit dhe orari”. Në vijim, me dt. 10 qershor 2022 NQ Termokos-it i është dërguar Kërkesa për të dhëna dhe informata për shqyrtimin tarifor, ku janë specifikuar të dhënat, informatat dhe dokumentet që NQ Termokos duhet të dorëzoj për shqyrtimin tarifor. Me 27 korrik 2022 NQ Termokos ka dërguar përmes e-mailit aplikacionin tarifor për sezonin 2022/’23.

Në këtë dokument janë dhënë komente për përbajtjen e aplikacionit për tarifa në përgjithësi, si dhe për përbajtjen e secilit dokument të dërguar në kuadër të aplikacionit. Komentet kanë të bëjë me kompletimin / jo-kompletimin e aplikacionit, duke treguar se cilët dokumente janë dorëzuar dhe cilat do duhen dorëzuar. Më tutje komentet elaborojnë në përgjithësi dhe jalin udhëzime për korrektesinë e dokumenteve që përmban aplikacioni për tarifa, dhe gjithashtu, pas vlerësimit të secilit dokument të dërguar, kërkohen korrigimet e nevojshme, informata dhe shpjegime shtesë.

### Përbajtja e Aplikacionit për Tarifa

Aplikacioni i tarifave i dorëzuar në formë elektronike nga NQ Termokos përmban këto dokumente:

- 1) Pasqyrat Rregullative me të dhënat dhe informatat e parashikuara për sezonin e ngrohjes 2022-2023:
  - a) Pasqyra A e aseteve operative – të dhënat e parashikuara për asetet fiks;
  - b) Pasqyra B e të ardhurave dhe shpenzimeve – të dhënat e parashikuara për të ardhurat dhe kostot (shpenzimet);
  - c) Pasqyra C e faturimit dhe arkëtimit – të dhënat dhe informatat për sipërfaqet e ngrohjes, kapacitetet dhe sasi të energjisë termike, faturimin dhe arkëtimin e konsumatorëve;
  - d) Pasqyra D e investimeve – të dhënat dhe informata për investimet kapitale të planifikuara;
  - e) Pasqyra E teknike - të dhënat e parashikuara për bilancin e energjisë termike, si dhe të dhënat teknike dhe të konsumatorëve (supozimet për kalkulimin e kërkesës reale për ngrohje, prodhimin dhe furnizimin e ngrohjes, dhe sipërfaqja ngrohëse e parashikuar).
- 2) Raporti i Auditorit dhe Pasqyrat financiare statutore për vitin 2021 – dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale:
  - a) Pasqyra e fitimit / humbjes (Bilanci i suksesit);
  - b) Bilanci i gjendjes;
  - c) Pasqyra e rrjedhjes së parasë; dhe
  - d) Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet.



- 3) Të dhënat dhe informatat tjera dhe dokumentet mbështetëse:
- a) Shpalosja (zbërthimet e detajuara) e pasqyrës B;
  - b) Planifikimin e prodhimit të energjisë termike nga ko-gjenerimi bazuar në parashikimin e kapaciteteve dhe sasisë së energjisë termike, si dhe të humbjeve përkatëse në rrjet; po ashtu edhe planifikimin e kostos së energjisë termike nga ko-gjenerimi.
  - c) Planifikimin e prodhimit të energjisë termike nga stabilimentet e prodhimit të ngrohtores së NQ Termokos, përfshirë edhe konsumin përkatës të lëndës djegëse – mazutit.
  - d) Planifikimet për sipërfaqen ngrohëse dhe konsumin e konsumatorëve për sezonin e ngrohjes 2022/23 bazuar në konsumin specifik të paralogaritur, si dhe humbjet në rrjet; gjithashtu edhe të dhënat të përbledhura nga baza e konsumatorëve – numri i konsumatorëve, sipërfaqet ngrohëse dhe kapaciteti termik përkatës.
  - e) Planifikimet për kyçjet e reja për sezonin 2022/23;
  - f) Detaje dhe shpjegime për Investimet e planifikuara me vetë-financim dhe nga donacionet;
  - g) Lista e nënstacioneve - të dhënat për sipërfaqet ngrohëse dhe kapacitetet përkatëse, si dhe të dhënat tjera teknike (e dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale);
  - h) Lista e aseteve – të dhënat detale për asetet fiksë ku janë dhënë vlera fillestare (e blerjes), zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme e aseteve (e dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale); dhe
  - i) Matjet e regjistruara për energjinë termike të prodhuar nga ko-gjenerimi (dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale);

#### **Komente për Përbajtjen e Aplikacionit të Tarifave**

Aplikacioni i tarifave i dorëzuar nga NQ Termokos është mjaft i kompletuar dhe në përputhje me kërkosat e ZRRE-së. Përveç pasqyrave rregulative dhe pasqyrave financiare statusore janë dhënë edhe të dhëna, informata shtesë në formë të detajimeve (shpalosjeve) dhe shpjegime shtesë për pozicionet kryesore të kostove operative dhe kapitale (investimeve), si dhe dokumente mbështetëse.

#### **Komentet për secilin dokument të dorëzuar në ZRRE**

- 1) Pasqyrat Rregulative me të dhënat dhe informatat e parashikuara për sezonin e ngrohjes 2022-2023:

- a) Pasqyra 'A' e aseteve operative – të dhënat e parashikuara për asetet fiksë;

Në pasqyrën A janë paraqitur asetet në vlerën fillestare (kostoja e blerjes), është dhënë zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme (vlera neto kontabël). Gjithashtu asetet janë paraqitur të ndara sipas aktiviteteve të licencuara: prodhimi dhe shpërndarja e furnizimi, si dhe asetet e përbashkëta. Nga vlera fillestare (kostoja e blerjes) në vlerë totale 87,701,038 € është zbritur zhvlerësimi i akumuluar në vlerë prej 27,605,643 €, që rezulton në vlerë neto kontabël prej 59,095,395 €. Nga analiza e aseteve ekzistuese dhe investimeve të reja të planifikuara vërehet se në vlerën totale të aseteve janë përfshirë edhe investimet e reja të planifikuara për periudhën e shqyrtimit tarifor. Sidoqoftë ZRRE, do të bëj llogaritjen e Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) bazuar dhe në përputhje me metodologjinë tarifore duke marrë parasysh RAB fillestare, që paraqet RAB-in e realizuar në sezonin 2021/2022, dhe investimet e planifikuara të arsyeshme dhe të lejuara në këtë shqyrtim tarifor.

#### **Përgjigje nga Termokosi :**



## Në rregull.

b) Pasqyra 'B' e të hyrave dhe shpenzimeve – të dhënrat e parashikuara për të hyrat dhe kostot.

- Të hyrat nga shitja e ngrohjes janë paraqitur në vlerë totale prej 8,563,880 €. Nga 'Shpalosja e pasqyrës B' vërehet se këtu përfshihen të hyrat nga faturimi për shërbimin e furnizimit me ngrohje në vlerë prej 8,452,380 €, e që përputhet me faturimin e planifikuar për shërbimin e furnizimit me ngrohje në Pasqyrë 'C'. Megjithatë sa i përket të hyrave nga shitja e ngrohjes duhet theksuar se këto do të përcaktohen gjatë shqyrtimit tarifor në vlerën e lejuar që do të mbuloj kostot operative dhe ato kapitale (zhvlerësimin dhe kthimin në asete).

Gjithashtu në shumën total të të hyrave janë paraparë edhe të hyra tjera të lejuara në vlerë 111,500 €; nga shpalosja vërehet se në këtë shumë janë përfshirë të hyrat nga kyçjet, nga shërbimet në rrjetin sekondarë etj. Lidhur me këtë është vërejtur një gabim në shpalosjen e Pasqyrës 'B' – pozicioni: 'zbritjet e lejuara nga faturimi në vlerë 40,000 € nuk janë zbritur por janë shtuar në shumë e të hyrave tjera të lejuara. Duhet të rishikoni këtë pozicion dhe të bëni përmirësimin adekuat.

### Përgjigje nga Termokosi :

➤ Është bërë përmirësimi në Shpalosjen e Pasqyrës B dhe Pasqyrën B .

- Për koston e energjisë termike nga ko-gjenerimi është paraqitur shuma prej 1,497,761 €. Kjo kosto e parashikuar gjithashtu është llogaritur në planifikimin e kostos së energjisë termike nga ko-gjenerimi (nën 'b') duke u bazuar në kapacitetet dhe sasitë e planifikuar të energjisë termike nga ko-gjenerimi dhe çmimet përkatëse, ku është llogaritur e njëjtë vlerë. Nga analizimi i kësaj kostoje dhe detajeve të ofruara është vërejtur se kjo kosto korrespondon me sasinë e planifikuar të energjisë termike të ekstraktuar nga ko-gjenerimi dhe çmimet aktuale përkatëse për sasi të energjisë dhe kapacitet. Megjithatë, sa i përket planifikimeve të prodhimit të energjisë termike nga ko-gjenerimi duhet theksuar se është vërejtur një mospërputhje në planifikim të kapacitetit elektrik të rezervuar krahasuar me planifikimet për Bilancin vjetor të energjisë – kjo me detajisht do shpjegohet më poshtë. Kjo mospërputhje do ndikon edhe në koston e energjisë termike nga ko-gjenerimi dhe duhet përmirësuar sipas përmirësimeve të planifikimeve të energjisë termike nga ko-gjenerimi.

### Përgjigje nga Termokosi

- Është bërë një gabim teknike në të dhënrat e planikuara për kapacitetit elektrik të rezervuar përmuat (janar deri në prill) 2023 dhe kjo ka rezultuar me gabime edhe në kalkulimet e vlerave të tjera teknike, e gjithashtu edhe në koston e energjisë termike nga koogjenerimi. Kemi bërë përmirësimet e duhura dhe janë përmirësuar të gjitha vlerat në tabelën 1, 2 dhe në Pasqyrat Rregullative B, E dhe në Shpalosjen e Pasqyrës B.

Në Pasqyrë 'B' ju keni paraqitur koston e prodhimit vetanak të energjisë termike nga kaldaçat në ngrrohtore respektivisht koston e lëndës djegëse (mazutit); në shpjegimet përkatëse keni dhënë llogaritjen e konsumit të mazutit për një periudhë 10 ditëshe (pika 'c') sipas rezervave të mazutit



(sasia e shfrytëzueshme 700 ton) e po ashtu keni dhënë shpjegimet përkatëse se jeni në proces të marrjes së lejes mjedisore nga Ministria e Infrastrukturës Ambientit dhe Planifikimit. Lidhur me këtë duhet theksuar se për shkak të mungesës së lejes mjedisore ZRRE nuk ka mundur t'ju licencoj për aktivitetin e prodhimit të energjisë termike nga stabilimentet (kaldajat) me mazut, e rrjedhimisht nuk mund të pranohet kostoja për një aktivitet të pa-licencuar. Për këtë, duhet t'ju informojmë se lejimi i kësaj kostoje për këtë shqyrtim tarifor do të varet nga progresi në lëshimin e lejes mjedisore nga Ministria dhe pastaj licencimit nga ZRRE.

#### Përgjigje nga Termokosi :

- Siq ju kemi informuar, me datë 09.08.2022 kemi Aplikuar për Leje Mjedisore të Integruar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI). Me këtë rast në MMPHI është dërguar Aplikacioni i plotësuar (me numër protokoli 1059/1 të datës 08.08.2022) dhe dokumentet mbështetëse, të kërkuaara në këtë Aplikacion. Lidhur me këtë çështje, jemi në pritje të vendimeve të MMPHI për rrjedhën e këtij procesi që ka të bëjë me plotësimin e kushteve të caktuara sipas legjislativës së fugu.

- Për koston e personelit në administratë dhe shërbimet tjera është paraqitur vlera e planifikuar prej 1,408,478 €, pra është paraparë një rritje prej rrith 27% nga vlera e realizuar në sezonin e kaluar 2021/22 (1,092,569 €). Po ashtu vërehet rritje e dukshme prej rrith 26% mes planifikimit dhe realizimit në sezonin e kaluar edhe për koston e personelit të prodhimit dhe shpërndarjes ('puna direkte' – 1,122,696 €). Lidhur me koston e personelit po ashtu vërehet diferençë e konsiderueshme në mes të vlerës së kësaj kostoje në Pasqyrat Rregullative të planikuara (totali i kostos së personelit: 2,828,994 €) dhe në Pasqyrat financiare statutore për vitin kalendarik 2021 (2,15,265 €); pra është një rritje prej mbi 600,000 €. Nevojitet të ofroni detaje për llogaritjen e kësaj kostoje duke dhënë numrin e punëtorëve, pagën mesatare dhe elemente tjera të kostos së personelit, si p.sh. kontributet / taksat etj. Po ashtu duhet dhënë arsyetimet përkatëse për rritjen e parashikuar.

#### Përgjigje nga Termokosi :

- Sipas Skemës së re organizative të aprovuar nga Bordi i Drejtoreve, Departamenti për Investime Kapitale (Njësi për zhvillime kapitale) si deparment i ri ende nuk është plotësuar me stafin e paraparë. Lidhur me këtë, në marrëveshje me KFE dhe Termokosin, KfE me mijte të veta ka angazhuar një konsulencë ndërkombëtare për rekrutimin e stafit të Departamentit për Investime Kapitale. Është planifikuar që ky staf të plotësohet gjatë vitit 2022, mirëpo për shkak të problemeve teknike në konkursin e shpallur nga konsulenca, nuk është rekrutuar stafi. Stafi i këtij departamenti sipas skemës organizative përbëhet nga drejtori dhe 11 punonjës. Buxhetimi për stafin e këtij



departamenti është bërë, për shkak se në rast të moisbuxhetimit rezulton në mosfinalizim të skemës organizative.

Edhe në D. e Distribuimit dhe D. e Prodhimit, bazuar në skemën e re organizative dhe për shkak të zgjerimit të rrjetit në lagjen Kalabria dhe Mati 1, është i domosdoshëm plotësimi i vendeve të lira me kuadrot e nevojshëm, inxhinierë dhe punëtorë të kualifikuar.

- Gjithashtu, duke pasur parasysh inflacionin në vend, Termokosi ka parapa edhe një përgindje të rritjes së pagave, pasiqë në vitin aktuan 2022, vërehet qartë se çmimet e produktevebazë në një periudhë shumë të shkurtë kohorejanë ngritur për 30%.

- Për pozicionet e kostove: 'Mirëmbajtja dhe riparimet' dhe 'Materialet dhe shërbimet' ju keni paraqitur parashikimet prej 146,300 € respektivisht 90,300 €. Këto vlera të planifikuara janë ndryshojnë dukshëm nga realizimet e sezonit të kaluar 2021/2022 (68,089€ respektivisht 122,605€). Nevojitet shpjegim adekuat për këto ndryshime të këtyre kostove të planifikuara.

Përgjigje nga Termokosi :

- Për mos realizimin e vlerave të planifikuara në tërësi gjatë vitit të kaluar, ka ndikuar shumë fakti që një numër i konsiderueshëm i kontratave nuk është realizuar për shkak të bllokimit të tenderëve në OSHP nga mungesa e Bordit të OSHP për një kohë relativisht të gjatë.
- Ndërkëq për ngritjen e vlerave për këto pozicione krahasuar me ato të vitit të kaluar, ka ndikuar shumë ngritja në shkallë shumë të lartë e kostove të materialeve dhe pajisjeve në tregun global.
- Nën pozicionin "Shpenzimet e shitjes dhe tjera administrative" është paraqitur vlera prej 442,750 €, dhe nga detajizimi vërehet se në këtë pozicion keni përfshirë edhe nën komponentën: "shpenzimet e tatimit në fitim"; lidhur me këtë duhet t'ju sqarojmë se fitimi, bazuar në metodologjinë tarifore, adresohet në Kthimin e Lejuar, i cili llogaritet bazuar në Bazën e Aseteve të Rregulluar me një normë kthim të arsyeshme. Ju lutem të konfirmoni gjetjet tona më lartë.

Përgjigje nga Termokosi :

- Në rregull.

- c) Pasqyra 'C' e Faturimit dhe Arkëtimit – të dhënat e parashikuara për sipërfaqen e ngrohjes, faturimin dhe arkëtimin
- o Në Pasqyrën 'C' ju keni parashikuar një sipërfaqe ngrohëse totale prej 1,647,865 m<sup>2</sup>; në këtë sipërfaqe totale, sipërfaqja e konsumatorëve me matje merr pjesë me 432,830 m<sup>2</sup> ndërsa sipërfaqja e konsumatorëve pa matje është parashikuar të jetë 1,215,035 m<sup>2</sup>.

Përgjigje nga Termokosi :

- Pas verifikimit të të dhënavë, ju njoftojmë se sipërfaqja e planifikuar është e saktë 194,809 m<sup>2</sup> sepse sipërfaqja e sezonës së fundit ka qenë 1,453,056.06+194,809=1,647,865.06 m<sup>2</sup>.

- o Nga analiza e jonë është vërejtur se, sipërfaqja e përgjithshme e ngrohjes është planifikuar të rritet për 182,580 m<sup>2</sup> nga sezioni i kaluar, që afersisht korrespondon me planifikimet e kyçeve të reja (planifikuar: 194,809 m<sup>2</sup>). Lidhur me kyçjet e reja respektivisht rritjen e sipërfaqes ngrohëse, duhet theksuar se planifikimet e juaja



reflektojnë kyçjet e reja të objekteve si rrjedhojë e dendësimit dhe zgjerimit të rrjetit sipas dinamikës së realizimit të projektit të KfW që është në vijim e sipër. Sidoqoftë, përveç kyçjes së objekteve duhet të analizoni edhe mundësinë e kontraktimit me konsumatorët banues të atyre objekteve në mënyrë që të jeni më real në planifikimet e sipërfaqeve ngrohëse.

**Përgjigje nga Termokosi :**

➤ Sa i përket analizës lidhur me mundësin e kontraktimit me konsumatorët banues të atyre objekteve që planifikohen të kygen, ne do ta marrim përbazë metodën krahasimore të objekteve të kyqyra vitet e fundit, ku ju njoftojmë se nga total sipërfaqia e kyçur në lagjen Kalabria, konsumatorë aktiv janë rreth 60% e banuesve, prandaj do ta marrim si bazë këtë përqindje dhe do ta bëjmë korigimin në Pasqyrën C.

- o Në përputhje me rritjen e parashikuar të sipërfaqes ngrohëse, në mënyrë të drejtë keni paraparë edhe rritjen e faturimit, si dhe gjithashtu edhe rritjen e nivelit të arkëtimit.
- d) Pasqyra 'D' e shpenzimeve investive – investimet kapitale të planifikuara
- Investimet e planifikuara të paraqitura nga ju janë shoqëruar me shpjegimet përkatëse për mënyrën e financimit – d.m.th. me vetë-financim dhe nga donacionet. Vërehet se pjesa dërmuese e investimeve planifikohet të financohet nga donacionet e organizatave / institucioneve ndërkombëtare (Qeveria Gjermane përmes KfW, Qeveria e SHBA-ve përmes MCC, BE-Banka Evropiane për Investime) me një pjesëmarrje të vogël të vetëfinancimit nga ndërmarrja. Shpjegimet shoqëruese gjithashtu përbajnjë detaje tjera të projekteve investive të paraqitura dhe janë paraqitur vlerat që planifikohen për periudhën njëvjeçare që përfshinë shqyrtimi tarifor, si dhe gjendjen gjegjisht fazat aktuale të këtyre projekteve. Duhet theksuar se projektet e planifikuara për sezonën 2022-23 janë të përfshira edhe në planin zhvillimor afatgjatë. Sidoqoftë, duke marr parasysh vonesat që kanë ndodhur në të kaluarën në realizimin e këtyre projekteve, dhe me qëllim të përcaktimin sa më real të Bazës së Rregulluar të aseteve, nevojitet një qasje sa më realiste në planifikimin e realizimit të këtyre projekteve.

**Përgjigje nga Termokosi :**

- Lidhur me planifikimin e realizimit të projekteve investive që planifikohet të financohet nga donacionet e organizatave / institucioneve ndërkombëtare, jemi mundur të paraqesim vlerat sa më reale duke u bazuar në afatin e përfundimit të projekteve sipas kontratave dhe në vlerat e tyre .
- a) Për projektin prodhimi i energjisë termike përmes energjisë solare "Solar 4 Kosova", bazuar në dokumentin për aplikim në WBIF , parashifet që punët për dizajnim dhe asistencë teknike të fillojnë në kuartalin e dytë të 2023, e që vlera për këtë është 5 milion euro.
  - b) Për projektin përfundim të kapaciteteve termike në 280MW, është në procedurë zgjedhja e konsulencës, prandaj vlera e paraparë për këtë projekt prej 1.5million eurosh ,mendojmë se është mjaft reale.



- c) Pojeti i KfW (T-2 ) "Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të tubacioneve", ky projekt sipas kontratws duhet të përfundoj me 15 janar 2023 dhe vlera e mbetur e kontratës prej 3,022,710.00 euro gjithsesi duhet të përmbyllt deri në muajin tetor 2023.
- d) Projekti i KfW (T-1 ) "Modernizimi dhe zgjerimi sistemit të NQ me termonënstacione të reja" ky projekt sipas kontratës duhet të përfundoj me 12 janar 2024. Vlera e kontratës është 7,784,573.17 euro dhe deri më tanë janë paguar avans 1,556,914.63 euro. Për periudhen raportuese (tetor 2022-tetor 2023), kemi planifikuar të realizohet vlera prej 4,359,360.978 euro, që mendojmë se është mjaft reale duke pasur parasysh periudhën një vjeçare të raportimit, pasiqë pjesa e pa paguar do të mbetet vlera prej 1,868,297.56 euro për periudhën tremuiore (tetor 2023-janar 2024).
- e) Për Projektin e MCC ,duke pasur parasysh se kontrata mbaron në dhjetor të vitit 2022, vlera e planifikuar prej 6,905,850.00 euro , gjithsesi duhet të paguhet deri në tetor të vitit 2023. Bazuar në dinamikën e kryerjes së punimeve, vërehet se kjo kontratë duhet të vazhdohet edhe në vitin 2023 dhe punët do të menaxhohen nga MFK- Komuna e Prishtinës, e që duhet të paguhën gjatë kësaj periudhe.
- Sa i përket investimeve me vetë-financim keni parashikuar një vlerë mjaft të madhe prej 5,389,000 €. Në këtë vlerë totale përfshihen investimet në pajisjet e prodhimit (1,598,500€) dhe në rrjetin e shpërndarjes (200,5000 €) dhe 3,590,000 € të kategorizuara në 'investimet e përbashkëta'; në 'investimet e përbashkëta' janë paraparë disa investime kryesore si: një pjesë e investimit në vlerë 1,000,000 € për ndërtimin e objektit administrativ, bashkëfinancimi në projektin e KfW në vlerë 2,000,000 €, dhe bashkëfinancim në vlerë 500,000 € për projektin e EU-EIB për dyfishimin e kapaciteteve të ko-gjenerimit. Lidhur me këtë duhet theksuar se në monitorimin e realizimeve të periudhës (sezoni) të kaluar është konstatuar se investimet me vetë-financim janë realizuar vetëm 48% (nga 1,611,000 € të lejuara janë realizuar vetëm 783,416€).

#### Përgjigje nga Termokosi:

- Sic u cek edhe në pikën më lartë , për mos realizimin e vlerave të planifikuara në tërësi gjatë vitit të kaluar, ka ndikuar shumë fakti që një numër i konsiderueshëm i kontratave nuk është realizuar për shkak të blllokimit të tenderëve në OSHP për shkak të mungesës së Bordit të OSHP për një kohë relativisht të gjatë.
- Investimet në Departamentin e Distribuimit :
- Për shkak të rritjes së vëllimit të punimeve në terren (kyçeve të reja, riparimit të rrjetit )dhe për shkak të ngrities së kostos së materialeve në tregun global, janë paraparë investime në vlerën prej 200,500.0 €.
- Investimet në Departamentin e Prodhimit/koogjenerimit :



1. Riparimi i pjesshëm i kaldajave K1 dhe K2 , vlera prej 500,000.00euro është në procedurë të prokurimit. Në vitin 2023 janë paraparë edhe 250 ,000.00euro për riparimin e tyre, duke përfshirë furnizimin dhe shërbimet e demontimit dhe montimit nga ekipe të specializuara për :  
-Ndërrimin e gypave të ekonomajzerit për kaldajat K1 dhe K2, ndërrimin e valvolave, ndërrimin e gypave të drenazhimit , rregullimi i piesës automatike, funksionalizimin e programit SCADA, riparimi dhe ndërrimi i senzorëve dhe punë të tjera duke mos i specifikuar një për një.
2. Furnizimi me Valvola DN 500 dhe DN 600 – në vlerë prej 125,000.00euro. Meqenëse nga viti 2019 janë zgjatur procedurat e prokurimit për funizim më këto valvola, aktualisht ky aktivitet është në përmbyllje të procedurave të prokurimit dhe shumë shpejt do të nënshkruhet kontrata me opertatorin. Këto valvola do të vendosen në dalje të ngrohores për rrjetin e shpërndaries.
3. Furnizim me diktuna për këmbyesit 50 MW - vlera prej 100,000.00euro është planifikuar për ndërrim të diktunave për këmbyesit 50 MW dhe njëkohësisht të kemi një sasi të diktunave rezervë.
4. Riparimi i gypave te "Laguna"- në vlerë prej 120,000.00euro- është në procedurë të prokurimit për zgjedhjen e operatorit për furnizim dhe shërbim. Planifikohet të ndërrohet një piesë e gypit DN600 i paraizoluar në rrjetin e koogjenerimit, në gjatësi prej 30m, për arsy se është dëmtuar izolimi i gypit nga ujërat nëntokësore. Edhe pse është intervenuar dy herë gjatë viteve të kaluara në sanimin e izolimit , është e nevojshme që të ndërrohet pjesa e dëmtuar e gypit.

#### ➤ Bashkëinvestimi për projektet zhvillimore

Meqenëse vlera prej 5.9million euro, do të paguhet nga Termokosi gjatë periudhës (2023-2024) si bashkëfinancues në projektin e KfW për "Zgjerim dhe rehabilitim të rrjetit", i cili është duke u zhvilluar aktualisht. Lidhur me këtë, gjatë kësaj periudhe raportuese, planifikohet bashkinvestim në shumën prej 2.5 milion eurosh. Sqarime më të detajuara janë dhënë në dokumentin "Raportet e detajuara për shq. tarifor të sezonit 2022/23".

Këtë ndryshim të vlerës për bashkëfinancim e kemi paraqitur në Pasqyrën Rregullative D dhe në tabelën nr.7.

Gjithashtu edhe për projektin e EU-EIB për dyfishimin e kapaciteteve të koogjenerimit, nga N.P."Termokos"sh.a janë zotuar 2.5 milion euro bashkëfinancim ( në 5 vitet e ardhëshme), prandaj për këtë periudhë raportuese , është planifikuar të paguhen 500,000 euro.

- Sa i përket konkretisht investimit të lejuar për ndërtimin e objektit të administratës, prej 482,000 € nuk është realizuar fare; po ashtu në vazhdimësi nga sezoni në sezonë vërehet rritja e vlerës së parashikuar për ndërtimit të objektit nga vlera fillestare që tani ka arritur në 2,320,000€. Kjo rritje nuk është shpjeguar / arsyetuar / argumentuar mjaftueshëm, ashtu që këto planifikime të arsyetohen dhe të pranohen në shqyrtimin tarifor.

#### Përgjigje nga Termokosi :



➤ Lidhur me mos realizimin të projektit gjatë vitit të kalur, siç ju kemi informuar problemi ka qëndruar tek zgjatja në vazhdimësi e procedurave të prokurimit për shkak të ankesave të operatorëve ekonomik në OSHP dhe nga mungesa e Bordit të OSHP. Meqenëse së fundmi Bordi i OSHP është zgjidhur, planifikojmë që në periudhën raportuese të zgjidhet operatori dhe të fillojë ndërtimi i objektit.

Sa i përket rritjes së vlerës së investimit, siç ju kemi informuar në raportimet e kaluara, arsyet qëndron se, me hartimin e projektit detali i ndërruar koncepti i ndërtimit të objektit duke rritur dukshëm përmasat e objektit dhe etazhitët (specifikat e projektit ua kemi dërguar në raportimet e mëparshme), që natyrisht ka rezultuar me një vlerë dukshëm më të madhe se vlera fillestare e paraparë, si për koston e ndërtimit të objektit, poashtu edhe në rritjen e kostos për mbikqyrje të punimeve.

Duke pasur parasysh gjendjen faktike të trendit të rritjes së çmimeve në vend dhe shkallën e lartë të inflacionit, nuk jemi të sigurtë nëse vlera e ndarë prej 2.2 milion euro për ndërtimin e objektit, do ta mbulojë koston e këtij projekti.

Për këtë periudhë raportuese, kemi planifikuar të realizojmë vlerën prej 1,000,000.00 euro për ndërtim të objektit dhe 60,000.00 euro për mbikqyrje të punimeve.

- e) Pasqyra teknike 'E' –të dhënat e parashikuara për bilancin e energjisë termike, si dhe të dhënat teknike dhe të konsumatorëve.

Nga analiza e kësaj pasqyre janë vërejtur disa mospërputhje dhe pasaktësi në paraqitjen e të dhënavë përkatëse:

- Në këtë pasqyrë keni paraqitur sasinë e energjisë termike nga ko-gjenerimi prej 280,702 MWh<sub>TH</sub>, përderisa në tabelën 2 të planifikimeve është vlerë tjetër – 316,554. Duhet të bëni përmirësimin e sasisë po ashtu duke konsideruar komentin më lartë në pikën 1.b, fq. 3.
- Gjithashtu për konsumin vetanak të energjisë termike (825 MWh) vërehet mospërputhje me planifikimet në tabelën 2 (670 MWh). Duhet të bëni korrigimin përkatës.

Përgjigje nga Termokosi :

- Është bërë korrigimi përkatës.
- Këto gabime pastaj janë reflektuar në pozicionet vijuese 13-16, ku sasia e energjisë termike e futur në rrjet është paraqitur më e vogël se sasia e furnizuar, që është gabim e mandej ndikon edhe në paraqitjen e gabueshme të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Të bëhen korrigimet përkatëse.
- Përgjigje nga Termokosi :
- Janë bërë korrigimet përkatëse.

- 2) Raporti i Auditorit dhe Pasqyrat financiare statutore për vitin 2021

Pasqyrat financiare statutore për vitin 2021: "Pasqyra e pozitës financiare", "Pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse", "Pasqyra e rrjedhjes së parasë dhe Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet", janë të



përfshira në Raportin e auditorëve të pavarur dhe të aprovuara nga menaxhmenti i ndërmarrjes dhe të nënshkruara nga zyrtarët kompetentë. Nuk ka ndonjë koment tjetër shtesë.

### 3) Dokumentet tjera mbështetëse:

#### 3.1) Investimet e reja

- Planifikimi i investimeve – të dhëna dhe informata për investimet kapitale të planifikuara në periudhën një vjeçare që përfshin sezonin 2021/2022. Në dokument janë dhënë ndarazi investimet e planifikuara me financim vetanak të ndara sipas departamenteve në vlerë totale prej 5,489,000 €, dhe nga donacionet në vlerë totale 20,787,921 €. Këto japin vlerë totale të investimeve të reja për periudhën në fjalë në vlerë 26,276,921 €; këto vlera të paraqitura përputhen me vlerat përkatëse të paraqitura në Pasqyrën ‘D’ të investimeve, përveç një shume të vogël prej 100,000 € tek investimet me vetëfinancim (në pasq. D janë paraqitur në vlerë 5,389,000 €), që duhet të korrigohet.

#### Përgjigje nga Termokosi :

- Janë bërë korrigimet përkatëse.

Gjithashtu janë dhënë përshkrime dhe shpjegime përkatëse lidhur projektet kryesore investive të finançuara nga donatorët si KfW dhe MCC dhe EU-EIB. Investimet e planifikuara të paraqitura në përgjithësi janë në përputhje me Planin Zhvillimorë Afatgjatë.

- **Investimet e reja me vetëfinancim**

Në këtë dokument janë paraqitur detaje për investimet e reja në:

- Prodhimin e energjisë termike në vlerë totale 1,598,500€, ku kryesisht përfshihen pajisje për stacionet e ekstraktimit dhe pranimit të energjisë termike nga ko-gjenerimi dhe kaldajat e ngrrotores, si dhe pajisje tjera si pompa, këmbyes e valvola.
- Shpërndarjen e energjisë termike në vlerë totale 200,500 €, ku përfshihet tubacione e fittingje dhe pajisje tjera të ndërlidhura.
- Në Investime të përbashkëta, ndër tjera, është planifikuar edhe ndërtimi i ndërtesës të zyrës qendrore administrative të NQ Termokos në vlerë total prej 2,320,000 € (2,200,000 € për ekzekutimin e ndërtimit dhe 120,000 € për mbikëqyrjen). Për periudhën njëvjeçare janë planifikuar realizimi në vlerën 1,060,000 € (1,000,000 € për ekzekutim të ndërtimit dhe 60,000€ për mbikëqyrje). Siç u përmend më lartë vlera e parashikuar e këtij investimi ka shënuar rritje në vazhdimësi nga sezioni në sezonë dhe kjo nuk është arsyetuar me argumente dhe fakte bindëse. Po ashtu lidhur me këtë investim duhet theksuar se ky projekt është paraqitur si planifikim edhe në shqyrtimin e kaluar tarifor, porse ende nuk ka filluar realizimi i tij për shkak të vonesave të ndërlidhura me procedurat e prokurimit / tenderimit. Nuk është paraqitur asnjë shpjegim shtesë lidhur me gjasat e përfundimit të këtyre procedurave në kuptim të afateve kohore. Në kuptim të planifikimit realist do duhej që ky investim të arsyetohet me dëshmi konkrete për progresin në kryerjen e këtyre procedurave të tenderimit dhe gjithashtu të reflektoj edhe në paraqitjen vlerave financiare përkatëse.

Sidoqoftë vërejtjet / komentet e bëra për Pasqyrën ‘D’ përgjithësisht për investimet vetanake (nën pikën ‘d’) vlejnë edhe këtu.

- **Investimet e reja nga donacionet**



Këto investime janë kategorizuar sipas projekteve dhe donatorëve përkatës (Qeveria Gjermane përmes KfW, Qeveria e SHBA-së përmes MCC dhe EU-EIB), ku janë paraqitur detajet teknike dhe financiare për këto projekte:

- Projekt i kFW, rehabilitim dhe zgjerimi i rrjetit dhe nënstacioneve në vlerën totale 7,382,071 € të planifikuar për këtë periudhë. Duhet theksuar se ky projekt investiv është në vijim e sipër dhe ka qenë i paraqitur edhe në shqyrtimin tarifor të sezonit të kaluar në vlerën 5,500,000 € dhe nga monitorimi është konstatuar se është realizuar pothuajse tërësisht kjo vlerë e investimit (më saktësisht 95.21%). Duke ju referuar dinamikës së realizimit dhe planit të implementimit, shuma e paraqitur vlerësohet si planifikim realist.
- Projekt i MCC-MFK Instalimi i pajisjeve matëse të ngrohjes qendrore është paraqitur në vlerë totale prej 6,905,850 € - vlera e kontraktuar me kryesin e punimeve instaluese dhe furnizimin e pajisjeve. Fillimisht duhet theksuar se ky projekt investiv ka qenë i paraqitur dhe lejuar në shqyrtimin e sezonit të kaluar por që gjatë asaj periudhe nuk kishte pasur realizim. Megjithëse ky projekt planifikohet të përfundoj në fund të këtij viti, duke pasur parasysh vonesat që janë shënuar për realizimin e këtij projekti, duhet një vlerësim real i planit të implementimit të projektit duke llogaritur edhe pengesat dhe vonesat në implementim. Gjithashtu duhet marrë parasysh faktin se një pjesë e konsiderueshme e aseteve të planikuara për investim konsiderohen si asete të konsumatorëve (alokatori, matësit individual në apartamente) dhe duhet një përcaktim të qartë të pronësisë së këtyre aseteve. Prandaj duhet të paraqitni shpjegime për aranzhimet potenciale lidhur me pronësinë e aseteve.

#### Përgjigje nga Termokosi :

- Kjo qështje ende përfundimisht nuk është definuar, por në takimet që i kemi mbajtur së bashku MFK-ZRRE-Termokos, jemi dakorduar që pronësia e aseteve (alokatori, matësit individual në apartamente) t'i mbetet Termokosit, duke u bazuar edhe në përvojën e kompanive të ngjashme në rexon.
- Projekt i KfW për prodhimin e energjisë termike nga energjia diellore 'Solar4Kosova' dhe Projekt i EU-EIB për dyfishimin e kapacitetit të ko-gjenerimit – për këto dy projekte keni paraqitur vlerat 5 mil € respektivisht 1.5 mil €, kryesisht për projektim dhe punët përgatitore të projektit, si dhe studim të Fizibilitetit. Bazuar në informatat e disponueshme këto dy projekte janë në fazën fillestare studimore dhe përgatitore; për këtë arsyesh rekandomohet një qasje realiste në planifikim përfshire këtu edhe planifikimet për periudhat e implementimit, që sipas vlerësime tona fillestare janë shumë të avancuara.

#### Përgjigje nga Termokosi :

- Për projektin e prodhimit të energjisë termike përmes energjisë solare "Solar 4 Kosova", bazuar në dokumentin për aplikim në WBIF , parashifet që punët për dizainim dhe asistencë teknike të fillojnë në kuartalin e dytë të 2023, e që vlera për këtë është 5 milion euro.

Po ashtu vërejtjet / komentet tjera të bëra për Pasqyrën 'D' për investimet nga donacionet (nën pikën 'd') vlejnë edhe këtu.



### 3.2) Planifikimet për kyçjet e reja për sezonin 2022/2023

- Janë paraqitur të dhëna mjaft detaje të paraqitura në formë tabelare për planifikimet e kyçeve të reja që përbajnjë të dhënrat për vendndodhjen (lokacionin) e objekteve, numrin e banesave dhe njësive afariste dhe sipërfaqet ngrohëse përkatëse. Sipas përshkrimit tabelarë vërehet se sipërfaqja totale e objekteve - kyçeve të reja të planifikuara është  $194,809 \text{ m}^2$ . Lidhur me këtë duhet theksuar se ky planifikim reflekton dendësimin dhe zgjerimin e rrjetit sipas dinamikës së realizimit të projektit të KfW që është në vijim e sipër. Sa i përket sipërfaqeve ngrohëse mund të vërehet një mos-përputhje e vogël me rritjen e planifikuar të sipërfaqes ngrohëse prej  $182,580 \text{ m}^2$ . Ju lutem të ofroni shpjegimet e nevojshme për sa u tha më lartë.

Përgjigje nga Termokosi :

- Vlenë përgjigja e njejtë si për pikën c -1 fq.5 , lidhur me verifikimin e vlerës së sipërfaqes për kyçjet e reja.

- Në planifikime e sipërfaqes ngrohëse ju sugjerojmë që, përveç kyçjes së objekteve duhet të analizoni edhe mundësinë e kontraktimit me konsumatorët banues të atyre objekteve në mënyrë që të jeni më real në planifikimet e sipërfaqeve ngrohëse.

Përgjigje nga Termokosi :

- Vlenë përgjigja e njejtë si për pikën c-2 fq.5 , lidhur me sipërfaqjen e kyçeve të reja.

### 3.3) Planifikimi i prodhimit të energjisë termike, furnizimit dhe humbjeve në rrjet

- Prodhimi i energjisë termike është parashikuar të jetë kryesisht nga stabilimentet e kogjenerimit në TC Kosova B, ku detajet janë paraqitur në formë tabelare për prodhimin e energjisë termike nga kogjenerimi bazuar në Bilancin e energjisë dhe në planifikimet përkatëse për pjesën e dytë të sezonin (janar – prill 2023). Në këto planifikime të kapacitetit elektrik të rezervuar vërehet një mospërputhje mes tabelës 1 të dokumentit juaj dhe planifikimeve po ashtu tuaja që janë dërguar për Bilancin e energjisë elektrike. Pra ju për shqyrtim tarifor keni planifikuar kapacitetin e rezervuar elektrik në vlerë  $49,240 \text{ MW}_{\text{EL}}/\text{h}$  ndërsa nga planifikimet për bilanc kjo vlerë llogaritet  $46,929 \text{ MW}_{\text{EL}}/\text{h}$ . Fitohet përshtypja se keni bërë disa gabime në tabelën 1 – p.sh keni parashikuar vlerë më të madhe në muajin mars 2023 se sa në shkurt, që kur merren parasysh temperaturat atmosferike në këta muaj nuk është parashikim real; po ashtu edhe për prill 2023 vërehet një mbi-planifikim. Mospërputhja në planifikimet për kapacitetin elektrik mandej përcillet në sasinë e extraktuar të energjisë termike, që ju keni përcaktuar në  $323,014 \text{ MWh}_{\text{TH}}$  ndërsa llogaritja sipas kapacitetit të rezervuar për Bilanc është  $307,854 \text{ MWh}_{\text{TH}}$ . Kjo natyrisht reflektohet edhe ne koston e energjisë termike nga ko-gjenerimi që është komentuar më lartë në fq.2, pika '1.b'. Duhet të ofroni shpjegimet përkatëse për këtë mospërputhje mes dy planifikimeve të bëra nga ju dhe të bëni korrigimet e nevojshme.

Përgjigje nga Termokosi :

- Është bërë një gabim teknik në të dhënrat e planifikuara për kapacitetit elektrik të rezervuar për muajt ( janar deri në prill) 2023 dhe kjo ka rezultuar me gabime edhe në kalkulimet e vlerave të tjera teknike, e gjithashtu edhe në koston e energjisë termike nga koogjenerimi. Kemi bërë



përmirësimet e duhura dhe janë përmirësuar të gjitha vlerat në tabelën 1, 2 dhe në Pasqyrat Rregullative B, E dhe në Shpalosjen e Pasqyrës B.

- 
- Është paraparë gjithashtu prodhimi i energjisë termike nga stabilimentet e prodhimit në Ngrohtore (prodhimi me mazut) për rastet e ndonjë ndërprerje eventuale të furnizimit nga kogjenerimi. Lidur me këtë duhet tju referoheni komentit përkatës për Pasqyrën 'B' (fq.2, pika '1.b') lidur me licencimin e stabilimenteve të prodhimit me mazut në ngrohtoren e NQ Termokos.

#### Përgjigje nga Termokosi:

- Sic ju kemi informuar, me datë 09.08.2022 kemi Aplikuar për Leie Mjedisore të Integruar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI). Me këtë rast në MMPHI është dërguar Aplikacioni i plotësuar (me numër protokoli 1059/1 të datës 08.08.2022) dhe dokumentet mbëshjtëse, të këruara në këtë Aplikacion. Lidur me këtë çështje, jemi në pritje të kërkesave të MMPHI për rrjedhën e këtij procesi që ka të bëjë me plotësimin e kushteve të caktuara sipas legjislacioneve në fuqi.

- Sa i përket vlerësimeve për furnizimin dhe humbjet në rrjet, duhet pasur parasysh dhe duhet bazuar në planifikimet përkatëse në Bilancet vjetore dhe afatgjata të energjisë termike. Gjithashtu për parashikimet llogaritjen e humbjeve në rrjetin e shpërndarjen duhet t'ju referoheni komentit përkatës për pasqyren 'E' (fq. 5 pika '1.e').

#### Përgjigje nga Termokosi :

- Është bërë përmirësimi i parashikimit të nivelit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, duke u bazuar në planifikimet përkatëse në Bilancet vjetore dhe afatgjata të energjisë termike. Ndryshimet e bëra janë paraqitur në tabelën 2 dhe Pasqyrën Rregullative E.

#### Shënim:

Këto komente janë dhënë me qëllim të korrigjimit dhe kompletimit të aplikacionit për tarifa në përputhje me kërkesat specifike të paraqitura aty.

Përgatitur nga:

Departamenti i Energjisë Termike dhe Gazit (DETG)